D E K R E T
Nr.7474, datë 12.3.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIV0-TOKËSORE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në rrethin e Krujës

Krijohet rajoni i qytetit të Laçit.
Fshati i bashkuar Sanxhak shkrihet.
Fshati Sanxhak përfshihet në juridiksionin e rajonit të qyteit të Laçit.
Rajoni i qytetit të Laçit ndahet në 5 lagje.
Fshatrat Katundi i Ri dhe Patok lidhen me rajonin e qytetit të Laçit.

Neni 2

Në rrethin e Tiranës

Lagjia e Poshtme shkëputet nga fshati Shkozë dhe lagjia Gjerovicë shkëputet nga fshati Tufinë dhe përfshihen në juridiksionin e qytetit të Tiranës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi më 15 prill 1991

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA